



Konrad
Adenauer
Stiftung



Shoqata e gazetareve të Maqedonisë



DORACAK GAZETARESK PËR NDJEKJEN E ZGJEDHJEVE





IMPRESSUM

Titull:

Doracak gazetaresk për ndjekjen e zgjedhjeve

Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

Autorë:

Erdem Ahmet

Përkthimi:

Isen Salju

Dizajni dhe përgaditja:

Marjan Delevski

Printo:

Vinsent grafika

Tirazh:

200

Foto:

Nga arkivat e SHGM

Publikimin mund ta shkarkoni prej:

<http://www.kas.de/mazedonien>

<http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/270>


Qëndrimet e preznetuara në publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë, por qëndrime personale të autorit



PËRMBAJTJA

- Mediat lozin rol thelbësor në zgjedhje	5
- Etika e gazetarëve dhe zgjedhjet	7
- Parrëgullësitë e zgjedhjeve	10
- Hulumtimi i opinionit publik	13
- Mediat publike dhe zgjedhjet	14
- Kodi i gazetarëve të maqedonisë	16
- Kuadri ligjor ndërkombëtar për lirinë e shprehjes	22
- Korniza ligjore për ndjekjen e zgjedhjeve	24
- Rregullore për fushatën zgjedhore	32
- Rregullore për periudhën parazgjedhore	38





"Sfida e gazetarëve për të qenë objektiv, të paanshëm dhe të balancuar është e përditshme, por nuk ekziston test më i rëndësishëm për profesionalizimin e tyre sesa ai në kushte të zgjedhjeve të ashpra politike. Zgjedhjet poashtu janë test për angazhimin politik për demokraci. Atëherë përpjekja për të manipuluar me median dhe për të kontrolluar informacionet është më i fuqishëm mes partive në pushtet, si dhe nga ana e liderëve politik që kandidohen për poste të ndrzshme publike".

Ajdan Vajt
Ish sekretari i përgjithshëm i Federatës
ndërkombëtare të gazetarëve.

MEDIAT LOZIN ROL THELBËSOR NË ZGJEDHJE

1.

Mediat sigurojnë informata për qytetarët lidhur me zgjedhjet.

Meqë vetëdija e qytetarëve për zgjedhjet varet në masë të madhe nga informatat e prezentuara nga media, gazetarët patjetër duhet të raportojnë duke u bazuar në fakte dhe në mënyrë të paanshmë për platformat politike dhe fushtat e të gjitha partive politike dhe kandidatët pjesëmarrëse në zgjedhje, për të mundur votuesi të bëjnë dallimin mes tyre dhe të marrin vendime të bazuara në informacion të mirë. Mediat, poashtu, patjetër duhet të kenë komente dhe analiza përt ngjarjet dhe çështjet, duke krijuar hapësirë për mendime të ndryshme nga një numër më i gjërë kolumnistësh dhe komentuesish. Deyrë tjetër e rëndësishme e medias është të transmetojë informacione nga Komisioni zgjedhor për të edukuar votuesit lidhur me faktet themelore për procesin e zgjedhjeve, për të drejtat dhe obligimet e votuesve, si të regjistrohesh si votues, ku të votojnë, si të garantojnë fshehtësinë e votimit, kush janë kandidatët e njësive zgjedhore etj.

2.


Funksioni i medias si "watch dog" në emër të publikut.

Mediat kanë obligim të raportojnë për çdo shkelje të të drejtave të kandidatëve ose votuesve (duke inkua-druar edhe të drejtën e fjalës) koruspionin në procesin zgjedhor nga partitë politike, mangësitë e organeve zghjedhore.

3.

Mediat duhet të jenë zëri i votuesve.

Zgjedhjet nuk janë vetëm për politikanët. Ato veçanërisht janë mundësi për njerëzit e zakonshëm të flasin dhe të identifikojnë problemet që për ato janë të rëndësishme. Gazetarët patjetër duhet të jenë mes njerëzve dhe të sigurojnë forum për njerëzit e zakonshëm që duan të thonë diçka, veçanërisht ata që hamenden, injorohe bile edhe ata që pengohen për të shprehur mendimin e tyre.



ETIKA E GAZETARËVE DHE ZGJEDHJET

Mbulimi i zgjedhjeve është një segment i rëndësishëm i lirisë së fjalës. Ashtu siç zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe demokratike, ashtu duhet të jetë edhe mbulimi i tyre. Mbulimi selektiv dhe i anshëm i zgjedhjeve është anatëmë për demokracinë. Për liri të vërtetë të shprehjes mediat duhet të jenë plotësisht të lira.

Mbulimi i zgjedhjeve nuk nënkupton vetëm të raportosh për fushatën zgjedhore dhe tubimet.

Gazetari përmes mbulimit të zgjedhjeve bëhet zëdhënës i të gjitha mendimeve: duke inkadruar edhe atë që promovojnë demokraci si dhe kundërshtarët e tyre. Në fushatat zgjedhore çdoherë do të përballen dy palë.

Gazetarët nuk duhet të shkelin mbi etikën profesionale duke shtrembëruar faktet, duke theksuar vetëm disa aspekte të stories, tituj që gabimisht reflektojnë përpmbajtjen e lajmit dhe, kuptohet, lajme, citate, njerëz dhe ngjarje tërësisht të fabrikuara.

Nga ana tjetër ato duhet në mënyrë të ndershme t'i sigurojnë informata dhe mendime. Duhet të shmanget raportimi pa mos provuar faktet bile edhe nëse informata është botuar në ndonjë media tjetër. Akuzat e pabaza dhe gjuha denigruese nuk janë të pranueshme për fushatën zgjedhore prandaj gazetarët nuk duhet të botojnë asgjë pa mos i mundësuar edhe palës tjetër t'i komentojë ose të jep përgjigje adekuate. Vetëm me gazetari të përgjegjshme mund t'u mundësohet votuesve mirë të infortmuar lirshëm të vendosin.

Paanshëmria dhe raportimi i balancuar janë apekte të rëndësishme të përgjegjësisë së gazetarit. Secililajm është e pamundur të jetë çdoherë i balancuar, po raportimi i paanshëm dhe i balancuar mes partive dhe kandidatëve konkurues mund të arrihet duke botuar një mori lajmesh gjatë tërë periudhës zgjedhore.

Gazetarët profesionist nuk duhet të anojnë nga asnjë kandidat. Detyra e tyre është të shtrojnë pyetje në emër të votuesve, t'i krahasojnë përgjigjet, të prezantojnë mendime të ndryshme, dhe të ofrojnë informata për kontekstin e ngjarjes. Kështu u jepet mundësi votuesve të kuptojnë se cilët qëndrime dhe mendime më së shumti janë të bazuara.

Saktësia është edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm i përgjegjësisë së gazetarit. Lajmi duhet të jetë i

saktë, jo vetëm duke shënuar emrat e individëve dhe të vendeve ashtu siç duhet dhe do të sigurohet se përshkrimi dhe citatet janë të sakta, por, me vënien e lajmeve në një kontekst të caktuar dhe duke u vënë theks të veçantë ngjarjeve dhe temave të rëndësishme. Njerëzit e humbin besimin në media kur do të shikojnë se nuk mund të mbështeten në saktësinë e lajmit që marrin.

Gazetarët nuk janë të vetmit që duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë për të qenë i përgjegjshëm në gazetari. Redaktorët kanë një rol të rëndësishëm në formësimin e produktit të medias dhe duhet të angazhohen të sigurojnë saktësi, paanshmëri dhe baraspeshë në mbulimin e zgjedhjeve.



PARRËGULLËSITË E ZGJEDHJEVE

Një moment i rëndësisëhm i zgjedhjeve është edhe niveli i ndershmërisë dhe transparencës. Bile edhe kur zgjdhet shpesh janë të monitoruara nga përfaqësuesit e partive politike, ekipet zgjedhore dhe jozgjedhore, gazetarët vetë duhet të përpiqen të zbulojnë nivelin e problemeve që ndikojnë në cilësinë e procesit zgjedhor.

MBULIMI I ZGJEDHJEVE

Dokument një redaktori i gazetës "The Nation"¹ nga Kenia, Zhon Lorens.

- të raportojnë për ngjarjet saktë ashtu siç kanë ndodhur e jo sikur do të dëshironit ju të ndodhnin. Kjo do të thotë se duhet të jeni i paanshëm në çdo aspekt.
- Jepni mundësi të barabarta për të prezentuar të gjithë kandidatët kryesor. Kjo do të thotë takime të balancuara me kandidatët.
- Jini të kujdesshëm që të mos i ngjyroni raportet tuaja me gjuhë provokative.
- Raportoni për atë që flasin kandidatët, e jo për atë që flasin palët e interesuara se çka kanë thënë kandidatët.

1 <http://www.thenation.com/authors/john-lawrence>

- Jini të kujdesshëm që të mos akuyoheni se mbani anën e ndonjë pale në debatet politike.
- Mos (në asnjë rrethanë) pranoni oferta prej ndonjë kandidati ose prej zëvendësve të tyre. Mos u vozisni me makinën e politikanit.
- Mos i premtoni asnjë politikani se në gazetë do të botohet raporti ose storia e tij. raportoni për atë që shikoni pa mos e tepruar.
- Mos e teproni kur përshkruani skena të turmave të njerëzve.

Ushtroni fer plej. Nëse kandidati akuzon kundërshtarin e tij, kërkoni koment nga kundërshtari.

Duhet t'i dëgjoni:

PREMTIMET:

Ato zakonisht janë pjesë e platformave të partive: premtime krenare për ndërtimin e sistemeve për ujitje, ndërtimin e rrugëve, uljen e taksave për arsim, ose ato mund të jenë lajme të shkurta me interes për fshatarët: "Votoni për mua dhe unë do ju jap dhjetë bagëti". "Votoni për mua dhe asnjë fëmijë i rajonit nuk do të jetë i çveshur", "Votoni për mua dhe barku juaj nuk do jetë i uritur". Prandaj patjetër duhet të jeni të kujdesshëm.

PROVOKATORË:

Provokatorët, njerrëz që duan të marrin fjalën duke u imponuar, mund të shkaktojnë dhunë ose përbuzje. Jini të kujdesshëm në raport me skenat humoristike. Mund të citoheni në të njëjtin kontekst.

E PAPRITURA:

Në tubimet publike shpeshherë ndodhin gjëra të papritura dhe prandaj duhet të jeni të kujdesshëm ndaj tyre.

KONTRADIKTA:

Jini të gatshëm për shmangie të papritur nga drejtimi i ndonjë fjalimi të përgaditur, veçanërisht nga deklaratat kontradiktore ose nga parimet themelore të platformës zgjedhore. Mos u mbështetni vetëm në tekstin e shtypur. Do të ju duhet forcë për vëzhgim të thelluar, do të ju duhet të vlerësoni disponimin gjatë takimit. Nëse është situata e tensionuar, e lirë, e hareshme? Shikoni përqark jush dhe vëzhgoni gjestikulacionin e fytyrave. Ka dikush që krijon probleme?

TURMA E POPULLIT:

Sa është e madhe turma? E rëndësishme është që të përcaktoni saktë përmasat e turmës. Por e mençur do të ishte të citohen burime të ndryshme: tuajt, të policisë, të organizatorit.

KONFRONTIME:

Në një atmosferë traznitore politike mund të ndodhë çdogjë. Disa shenja do t'u përgaditin. Numri i personave të infiltruar të opozitës. A janë të armatosur (bile edhe me gurë). Dëgjoni atë që thuhet nga personat e turmës. Vëzhgoni praninë e njerëzve të sigurimit, nëse janë të armatosur me helmeta, shkopinj gome, armë dhe lotësjiellës. Nëse ato presin probleme. Duken të shqetësuar? Mos sillni shpejt konkluzione lidhur me atë se si ka nisur problemi nëse përnjëherë shkaktohet tollovi.

Folni me njerëzit ndoshta nuk keni regjistruar diçka ose ndonjë akt provokativ.

HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK

Hulumtimi i opinionit publik është karakteristikë e për-bashkët për pjesën dërmuese të zgjedhjeve. Ato mund të organizohen nga ana e mediave, partive politik ose nga shërbimet sociale. Shumica e hulumtimeve të opinionit publik që janë organizuar nga ana e mediave janë të bazuara në modelin e “garave”: kush udhëheq, kush është i fundit? dhe shpeshherë kanë rol të tepruar në mbulimin e fushatave.

Në faktë nga gazetarët pritet të komentojnë hulumtimet që janë të organizuara nga të tjerët. Sipas asaj, ato kanë nevojë për njohuri themelore për teknikat e hulumtimit të opinionit publik. Për tu analizuar dhe në mënyrë ad-ekuate për tu komentuar të dhënat lidhur me anketën, por edhe të përcaktohen manipulimet e mundshme ose komentimet e gabuara.

MEDIAT PUBLIKE DHE ZGJEDHJET

1. Mediat publike duhet patjetër t'i informojnë të gjithë qytetarët

Gjatë zgjedhjeve të para mediat publike duhet patejtër t'i sigurojnë opinionit informata relevante që të mundin qytetarët të kenë njohuri për ofertat politike që ofrohen në zgjedhje. Posaçërisht, mediat qeveritare patjetër të sigurojnë informata për:

- partitë politike dhe kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje
- çështjet që janë kyçe për fushatën, duke inkuadruar edhe materialet nga manifestimet e partive
- Procesi i votimit dhe të gjitha informatat e tjera që do tu ndihmonin njerëzve të marrin pjesë në zgjedhje.

2. Mediat publike patjetër duhet të jenë të paanshme

Mediat publike patjetër duhet të jenë të paanshme dhe të balancuara gjatë transmetimit të lajmeve dhe informatave që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Veçanërisht, mediat qeveritare duhet të sigurojnë që serviset programeore dhe informative të jenë të paanshme në raport me të

gjitha partitë ose kandidatët, por poashtu, duhet të sigurojnë qasje të barabartë deri te mediat për të gjithë kandidatët dhe partitë që marrin pjesë në zgjedhje.

3. Mediat publike patjetër duhet të jenë profesionale

Mediat publike patjetër duhet të demonstrojnë standarde më të larta të gazetarësisë dhe patjetër të sigurojnë mbulim të balanuar, të saktë dhe të paanshëm të zgjedhjeve, ndërsa njëkohësisht qeveria patjetër të sigurojë mekanizma për rregullimin dhe monitoimin e programeve që emitojnë lidhur me zgjedhjet.



KODI I GAZETARËVE TË MAQEDONISË


Kodi i gazetarëve të Maqedonisë i miratuar me 14 nëntor të vitit 2001 vetëm në nenin 14 flet për zgjedhjet:

“Raportimi nga proceset politike, vveçanërisht zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balncuar. gazetari patjetër duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike”.

Ky nen do të thotë se gazetarët çdoherë në mënyrë kritike do ti ndjekin proceset politike, si dhe përdorimi dhe keqpërdrimi i mundshëm i fuqisë politike dhe ekonomike. Gazetarët nuk do të bëjnë propagandë në dobi të asnjë partie politike ose opasioni politik. Kur bëhet fjalë për kumtesat e partive politike ose të grupeve apo organizatave të tjera kjo duhet qartë të theksohet, ndërsa gjatë përpunimit redaksional nuk guxojnë të shtrembërohen faktet, konteksti dhe kuptimi. Mosbotimi i ndonjë lajmi nuk guxon të jetë e lidhur me arsye ideologjike dhe partiake.

Në nenet tjera të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë edhe pse nuk përmenden zgjedhjet ato plotësisht janë të zbatueshëm edhe gjatë zgjedhjeve.

Gazetarët profesionist gjatë mbullimit të zgjedhjeve kanë përgjegjësi të njëjtë sikur edhe kur mbulojnë çdo temë tjetër. Nuk ekziston etikë e evaçantë e gazetarëve për zgjedhjet por standardet, etika dhe parimet e njëjta profesionale që vlejnë për punën e përditshme të gazetarëve janë të zbatueshme edhe për zgjedhjet. Megjithatë zgjedhjet çdoherë paraqesin testin me sfidaues për etikën e gazetarëve. Pikërisht për shkak të këtyre arsyeve në mbarë botën shoqatat profesionale të gazetarëve përgadisnin doracakë të ngjashëm për mbullimin e zgjedhjeve, ndërsa redaksitë informative të mediaeve i trajnojnë gazetarët e vet me sfidat e procesit zgjedhor.



KODI I GAZETARËVE TË MAQEDONISË PARIMET E SJELLJES

Liria e mediave është e drejtë e pakontestueshme. Detyra themelore e gazetarëve është respektimi i të vërtetës dhe të drejtës së opinionit të jetë i informuar, në përputhje me nenin 16 të kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Roli i gazetarëve është shpërndarja e informatave, ideve dhe mendimeve dhe e drejta për të komentuar. Duke respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale në transmetimin e informatave, gazetarët duhet të jenë të ndershëm, objektivë dhe të saktë. E drejtë dhe detyrë e gazetarëve është që të përpiqen të parandalojnë censurën dhe shtrembërimin e informatave.

Duke ndjekur rolin e tyre në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë qytetare, gazetarët do të mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do të respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në kontrollimin e pushtetit dhe subjekteve tjera të jetës publike.

DUKE U BAZUAR NË KËTO PARIME DHE VLERA ETIKE:

1. Gazetari ka të drejtë për qasje të lirë gjer të gjitha burimet e informimit, të cilat janë në interes publik. Gazetari duhet të botojë informata të vërteta e të konfirmuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale ose të falsifikojë dokumente. Në qoftë se informata nuk mund të konfirmohet, ose nëse bëhet fjalë për supozim, respektivisht spekulim, kjo gjë duhet cekur dhe botuar. Saktësia e informatës duhet vërtetuar aq sa është e mundur.

2. Nëse gazetari pa arsye pengohet që të marrë informatën e kërkuar, ai ka të drejtë që për këtë të informojë opinionin.

3. Gazetari do të tentojë që të sigurohet e drejta për korrigjim, demant dhe përgjigje, në ato raste kur vërtetohet pasaktësia e informatës.

4. Gazetari do të cekë burimin e informatave, mirëpo, nëse burimi kërkon që të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë atë.

5. Gazetari do të respektojë ligjet në shtet, mirëpo nuk do të publikojë ose fshehë asgjë që është në kundërshtim me interesin publik.

6. Gazetari nuk guxon të shfrytëzojë mediumin për publikimin ose fshehjen e informatave për përfitimin e të mirave për vetveten. Ryshfeti, korrupsioni dhe reketi janë

të gjëra të papërputhshme me profesionin e gazetarit. Nuk guxon të lejohet që reklamimi dhe motivet tjera komerciale të kenë influencë mbi lirinë e informimit. Duhet pasur dallim mes reklamimit dhe tekstit gazetaresk me ilustrim.

7. Gazetari duhet të respektojë jetën private të personit, përveç në raste kur kjo bie në kundërshtim me interesin publik. Gazetari e ka për detyrë të respektojë dhimbjen dhe zinë personale.

8. Mënyra e informimit në rastet e fatkeqësive, katastrofave natyrore, luftërave, tragjediave familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jenë të çliuara nga senzacionalizmi. Në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i pafajshmërisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në mosmarrëveshje dhe të mos jepen sugjerime lidhur me vendimin.

9. Gazetari nuk duhet të bëjë intervista ose të fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve ose tutorëve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë nuk ka të bëjë me të drejtat e fëmijës. Kjo gjë vlen po ashtu për personat me nevoja speciale, të cilët nuk janë në mundësi që të gjykojnë me vetëdijen e tyre.

10. Gazetari nuk ka për të krijuar ose përpunuar me vetëdije informata, të cilat i kërcënojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk ka për të folur me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)

11. Gazetari do t'u përmbahet standardeve të pranuarara shoqërore që kanë të bëjnë me dinjitetin dhe respektimin e dallimeve etnike, kulturore dhe religjioze në Maqedoni.

12. Bërja e plagjiatëve është e palejueshme. Citatat nuk duhet të shfrytëzohen pa miratimin e burimit ose autorit.

13. Gazetarët duhet të bëjnë dallim ndërmjet fakteve dhe mendimeve, ndërmjet lajmit dhe komenteve.

14. Raportimi për proceset politike, veçanërisht zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar. Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale prej subjekteve politike.

15. Gazetari duhet ta kultivojë kulturën e të folurit dhe etikën. Komunikimi i pasjellshëm me opinionin nuk ka të bëjë aspak me profesionin e gazetarit.

16. Gazetari do ta ruajë prestigjin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do ta nxisë solidaritetin reciprok dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdorë mediumin e tij për larjen e hesapeve me persona të ndryshëm përfshirë këtu edhe kolegët e tij.

17. Gazetari ka të drejtë të refuzojë urdhrat për punë në qoftë se një gjë e tillë është në kundërshtim me parimet e këtij Kodeksi.

RREGULLA PËRMBLEDHËSE

Gazetarët që punojnë në përputhje me këtë Kodeks e gëzojnë përkrahjen e mediave të tyre dhe të organizatave të tyre profesionale.

Në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë, gazetarët do ta pranojnë gjykimin profesional vetëm prej kolegëve të tyre dhe do të jenë jashtë ndikimeve politike dhe ndikimeve të tjera.

Për respektimin e parimeve të këtij Kodeksi kujdeset Këshilli i Nderit i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë.

Shkup, 2001/11/14. Gazetarët e Maqedonisë

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR PËR LIRINË E SHPREHJES

Korniza ndwrkombwtare lifgjore pwr lirinw e shprehjes Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë. **(nëni 19 I Deklaratws universal pwr tw drejtat e njueriut²)**

2 <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml>

Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. **(nëni 19 alineja 2 e paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike)**

KORNIZA NDËRKOMBËTARE LIGJORE PËR ZGJEDHJET

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.

3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë. **(nëni 21 I Deklaratës universale për të drejtat e njeriut)**

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

(a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

(b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;

(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

(nëni 25 i paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike).

KORNIZA LIGJORE PER NDJEKJEN E ZGJEDHJEVE

Roli i mediave në zgjedhje në Maqedoni është definuar në Kodin zgjedhor dhe në dy rregulloret që i miraton Këshilli për radiodifuzion në bashkëpunim me Komisionin shtetërorë të zgjedhjeve. Njëra rregullore ka të bëjë me qasjen e barabartë të prezantimit në media gjatë fushatës zgjedhore ndërsa tjetri definon rolin e radiodifuzerëve në periudhën para nisjen së fushatës zgjedhore.

Në Kodin³ zgjedhor fushata zgjedhore definohet si tu-

3 [http://www.sec.mk/Predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_\(Precisten_tekst\).pdf](http://www.sec.mk/Predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_(Precisten_tekst).pdf)

bime publike dhe ngjarje publike të organizuara nga partitë politike dhe kandidatët e pavarur. Fushata përfshinë ekspozimin publik të materialit propagandues zgjedhor dhe të prezentimet e videove në vende publike, prezntim zgjedhor në media, distribuimin e materialit të shtypur dhe prezentimin publik të kandidatëve të konfirmuar nga Komisioni shtetërorë i zgjedhjeve. Personat e huaj fizik dhe juridik nuk mund të organizojnë e as të marrin pjesë në fushatën zgjedhore.

Sipas këtij Kodi, fushata zgjedhore nis 20 ditë para zgjedhjeve dhe mbaron një ditë para ditës së votimit.

Prezentimi në media

Radiodifuzerët janë të obliguar që në programet e tyre gjatë fushatës zgjedhore të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje. Televizionet dhe radiot që i ndjekin zgjedhjet mund të emitojnë reklamë shtesë prej 15 minutash për një orë reale të programit të emituar, vetëm për reklamë politike, prej të cilit për një pjesëmarrës në fushatë më së shumti 10 minuta.

Radiodifuzerët dhe gazetatat janë të obliguar pesë ditë para shpalljes së zgjedhjeve të përcaktojnë çmimet

për reklamën politike për programet zgjedhore dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje. Ato, prej ditës së përcaktimit të çmimeve deri në ditën e fillimit të fushatës zgjedhore, janë të obliguar që të paktën dy herë t'i publikojnë në programet e tyre dhe gazetat. Cmimet nuk guxojnë të ndryshohen gjatë fushatës, ndërsa radiodifuzerët dhe mediat e shtypura janë të obliguar që ato t'i dorëzojnë në KSHZ, KRD dhe deri te Enti shtetërorë për revizion.

Radiodifuzerët edhe mediat e shtypura janë të obliguar:

- Të sigurojnë qasje të barabartë për reklamë të paguar politike për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje
- Reklama duhet të jetë shënuar dukshëm si reklamë e paguar politike dhe të ndahet prej programit tjetër
- Porositësi i çdo forme të reklamës së paguar politike patjetër qartë të shënohet dhe të ndahet nga pjesa tjetër e programit dhe nga reklamat tjera
- Ndalohet pjesëmarrja e fëmijëve në reklamën e paguar politike

Radiodifuzerët nuk guxojnë:

- Të emtojnë reklama politike në lajme dhe programet ditore informative
- Të emtojnë reklama në programe arsimore dhe për fëmijë, dhe nga transmetime të ngjarjeve sportive, kulturore dhe zbavitëse
- Në programe të veçanta informative
- Servisi publik nuk guxon të emitojë reklamë të paguar politike

Ndjekja zgjedhjeve


RTVM është i obliguar falas dhe në bashkëpunim me KSHZ t'i informojë qytetarët për procesin e përgjithshëm të organizimit dhe të zbatimit të zgjedhjeve. Gjatë zgjedhjeve RTVM është i obliguar:

- të emtojë falas prezentim politik për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje
- KRD është i obliguar të ndjek mënyrën e mbulimit të zgjedhjeve nga media nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e tyre
- KRD kur do të konstatojë parregullësi është i obliguar të ngrejë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kundër radiodifuzerëve

Hulumtimi i opinionit publik

Rezultatet nga hulumtimi i opinionit publik lidhur me zgjedhjet mediat mund t'i publikojnë pesë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe kanë obligim që:

- Të theksojnë emrin e atij që ka porositur dhe ka paguar hulumtimin
- Institucionin që ka zbatuar hulumtimin dhe metodologjinë e zbatuar
- Përmasat dhe strukturën e të anketuarve
- Periudha e zbatimit të hulumtimit



Gjobat për kundërvajtje

Kodi zgjedhor parasheh gjoba për kundërvajtje për mosrespektimin e detyrimeve nga media dhe nga kryeredaktorët nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e tyre. Për mosrespektimin e dispozitave të kodit, mediat mund të gjobiten prej 1500 deri në 5 mijë euro, ndërsa gjobat për kryeredaktorët varojnë nga 300 deri në 3 mijë euro, varësiosht nga kundërvajtja.

Obligimet e organizatorëve të fushatës zgjedhore

Partitë politike dhe kandidatët e pavarur, sipas Kodit zgjedhor, kanë për obligim të hapin xhirollogari për finansimin e fushatës zgjedhore në afat prej 48 orësh pas konfirmimit të listës së kandidatëve. Dy ditë pas këtij afati duhet të dorëzohet dëshmi me shkrim në KSHZ se obligimi është përmbushur. Në rast se nuk plotësohet ky obligim në kohë partia ose kandidati i pavarur nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje.

Të gjitha mjetet për fushatën duhet të shkojnë përmes xhirollogarisë së veçantë dhe vetëm prej saj mund të mbulohen harxhimet e fushatës. Xhirollogaria mbyllet pas mbarimit të zgjedhjeve, kur nga buxheti i shtetit dhe i komunave do të paguhen mjetet për partitë dhe kandidatët e pavarur për votat e fituara.

Për fushatën përgjegjëse është vetëm organizatori i saj edhe atëherë kur autorizon dikënd tjetër që në emër të tij të ndërmerr veprime.

Për çdo shkelje të të drejtave në fushatë kandidatët gezojnë mbrojtje gjyqësore. Gjykata vendos në afat prej 48 orësh nga pranimi i kërkesës. Vendimi i gjykatës mund të ankimohet nga kandidati dy ditë pasi ta ketë marrë atë. Gjykata e apelit vendos në afat prej 48 orësh nga moemnti i pranimit të ankesës.

Pushteti ekzekutiv dhe lokal prej ditës së shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e tyre nuk guxojnë të shpenzojnë mjete për pagesa të jashtëzakonshme të rrogave, pensioneve, ndihmave sociale dhe pagesave tjera nga buxheti dhe prej fondeve publike.

Me ndryshimet e fundit të Kodit zgjedhor shtohen obligime të reja për pjesëmarrësit në zgjedhje. Anëtarët e qeverisë dhe zëvendës ministrat nga dita kur do të konfirmohen si kandidatë për zgjedhje, funksionin e zbatojnë vetëm për funksionimin teknik të institucionit.

Këto bartës të funksioneve publike nuk guxojnë të disponojnë me mjete publike, përveç nëse është rregulluar ndryshe me ligj tjetër me të cilin rregullohet finansimi i fushatës zgjedhore të partive.

Me mjete publike nuk guxojnë të nisin ndërtimin e objekteve të reja të infrastrukturës dhe të objekteve me rëndësi shoqërore, përveç nëse janë paraparë me programin vjetor në vijim.

Këto persona e kanë të ndaluar të paguajnë roga, pensione, ndihma sociale dhe pagesa tjera të jashtëzakonshme nga mjetet e buxhetit ose nga fondet publike, e as që mundin të shesin kapital shtetërorë, e as që të nënshkruajnë marrëveshje kolektive. Kjo ndalesë fillon nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri kur të mbarojnë ato.



RREGULLORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE

Në rregulloren⁴ për qasjen e barabartë në prezntimin në media gjatë fushatës zgjedhore janë paraparë format e prezntimit në media, mënyra e sigurimit të qasjes së barabartë të pjesëmarrësve në zgjedhje si dhe mënyra e raportimit të mediave gjatë heshtjes zgjedhore.

Servisi publik dhe mediat private që kanë vendosur të ndjekin zgjedhjet, janë të obliguara ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme.

Të gjithë radiodifuzerët gjatë fushatës janë të detyruar që të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje t'u sigurojnë qasje të barabartë deri te të gjitha format e prezntimit për zgjedhje në media. Kjo do të thotë se në emisionet ditore informative, programet me të cilat organizatorët në mënyrë të drejtpërdrejtë tu drejtohen votuesve dhe në emisione të veçanta informative.

4 http://srd.org.mk/images/stories/IZBORI_2011/ZA_SLUZBEN_VESNIK_-_Pravilnik_z_a_ramnopraven_pristap_z_a_vreme_na_kampanja.pdf

Me rregulloren liria e politikës redaktuese është e garantuar, por radiodifuzerët kanë për obligim për të qenë të balancuar në prezentimin në media të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje.

Përveç parimit për të qenë i balancuar, në rregullore theksohen edhe parimi i barazisë dhe proporcionalitetit për të gjithë kandidatët në zgjedhje. Parimet e fundit nuk vlejnë për reklamimin politik.

Gjatë fushtës dhe në heshtjen zgjedhore radiodifuzerët nuk guxojnë të emritojnë shpallje dhe reklama të finansuara nga paratë publike.

Redaktorët, gazetarët, drejtuesit dhe prezantuesit të angazhuar në përgaditjen e programit të radiodifuzerëve, nuk guxojnë të marrin pjesë në fushatën zgjedhore të pjesëmarrësve në zgjedhje.

Ata që do të inkuadrohen në ndonjë fuhshatë zgjedhore, angazhimi i tyre në media duhet të pushojë deri në mbarimin e zgjedhjeve.

Radiodifuzerët nuk guxojnë të emitojnë përmbajtje që nxisin rënimin me dhunë të rendit kushtetues, nxisin urrejtje dhe ftojnë për agresion ushtarak ose nxisin çfardo lloj të gjuhës së urrejtjes dhe mosdurimit. Nëse kjo ndodhë radiodifuzerët janë të obliguar të distancohen prej tyre dhe të sigurojnë konetkst kritik për të zbutur efektet negative.

RTVM është i obliguar që të ndjek të gjitha aktivitetet lidhur me fushatën zgjedhore, informon për legjislacionin e zgjedhjeve, për aktivitetet e pjesëmarrësve në zgjedhje, dhe për rrjedhën e votimit dhe të shpalljes së rezultateve. Përveç kësaj, është i obliguar që të informojë qytetarët për teknikën e votimit, ndërsa siguron edhe informacion vazhdimisht edhe për personat me dëgjim të dëmtuar.

Radiot dhe televizionet private që do të vendosin për të emtuar prezentim falas politik, duhet të sigurojnë kohë të balancuar për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje. Prezentimi falas duhet qartë të shënohet gjatë tërë kohës së emitimit. Data dhe radhitja e emitimit të pjesëmarrësve përcaktohet me short.

Lajmet dhe ditarët e mediave gjatë fushatës duhet të përgaditën duke u udhëhequr nga parimet profesionale. Informim i balancuar, proporcional dhe i barabartë për aktivitetet e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje. Parimi për të qenë i balancuar ka parasysh edhe intenzitetin e aktiviteteve të aktorëve në zgjedhje.

Komentet për fushatën në lajme dhe ditare ndahen si kontribute të veçanta, të dallueshme me emërin dhe mbiemrin e autorit ose si koment redaktorial.

Në programet të destinuara për informimin për mënyrën dhe teknikën e votimit dhe të ushtrimit të drejtës së votës, si dhe në intervista, debate dhe përballje, radiodifuzerët të udhëhequr nga parimet profesionale për të qenë të balancuar dhe proporcional, duhet të sigurojnë qasje të barabartë në media për të gjithë pjesëmarrësit. Në këto programe të veçanta informative nuk guxojnë të përdoren si formë për reklamim të paguar politik.



HESHTJA ZGJEDHORE

Gjatë heshtjes zgjedhore, i cili nis 24 orë para ditës së votimit dhe mbaron në momentin e mbylljes së vendvotimeve, ndërpriten të gjitha format e prezentimit zgjedhor në media për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje.

Radiodifuzerët guxojnë të raportojnë për zgjedhjet, por do të shkelin heshjten nëse:

- Emitiojnë informata dhe material tjetër në funksion të ndonjë fushate ose mesazhe promocionale për prezentimin e programit të partisë ose simbole për cilindo kandidat dhe pjesëmarrës në zgjedhje ose shtabeve partiale
- Për funksionarë publik në funksion të fushatës që ndikon në vendimin e votuesve
- Prezentim në media i hapur apo i fshehur që mund të ndikojë mbi vendimin e qytetarëve
- Shenja partiake dhe simbole ose material tjetër propagandues, të orientuar për ose kundër ndonjë pjesëmarrësi në zgjedhje ose bartësit në funksionit publik
- Deklarata, kumtesa, të dhëna në funksion të ndonjë kandidati, partie ose pjesëmarrësi tjetër në zgjedhje

- Pjesëmarrja e kandidatëve dhe funksionarëve në orograme të veçanta informative lidhur ose në funksion të fushatës zgjedhore
- Programe të inçizuara osë të drejtpërdrejta, lidhur me zgjedhjet, për kandidatët, funksionarët
- Pika muzikore, spote dhe prezentim tjetër artistik i kandidatëve në zgjedhje

Rregullorja si reklama që prezentojnë programe he simbole partiale i çmon të gjitha format e prezentimit të drejtpërdrejtë të pjesëmarrësve në zgjedhje drejtuar votuesve padallim nëse është e paguar apo jo:

- Shpallje dhe kumtesa
- Spote zgjedhore politike
- Pika muzikore si himne partish
- Transmetime ose imazhe nga tubimet zgjedhore
- Takime dhe aktivitete tjera të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore

Radiodifuzerët mund të raportojnë për parrëgullësit gjatë votimit si dhe për incidentet duke mbajtur llogari për të emituar :

- Informacione të provuara nga burime zyrtare
- Nuk guxojnë të publikojnë identitetin e subjektit politik deri në mbarim të zgjedhjeve
- Pjesëmarrësit në zgjedhje nuk guxojnë të trajtohen si burime zyrtare

- Të mos lejojnë të keqpërdoren nga pjesëmarrësit në zgjedhje duke transmetuar akuzat e tyre të pabaza
- Kumtesat partiake botohen pas mbarimit të votimit

Ditën e votimit radiodifuzerët nuk guxojnë të emitojnë:

- Deklarat të kandidatëve në zgjedhje, të liderëve partiak, funksionarëve dhe ppolitikanëve
- Deklarata të qytetarëve dhe të subjekteve të tjera në funksion të fushatës

RREGULLORE PËR PERIUDHËN PARAZGJEDHORE

Në rregulloren⁵ për sjelljen e radiodifuzerëve gjatë periudhës para nisjes së fushatës zgjedhore rregullohen përmbajtjet që nuk guxojnë të trajtohen si prezantim zgjedhor në media që nuk lejohen në fushatë. Përveç kësaj rregullorja përcakton edhe mënyrën e sjelljes së radiodifuzerëve prej shpalljes së zgjedhjeve deri te fillimi i fushatës.

Sipas kësaj rregullore para fillimit të fushatës radiodifuzerët nuk guxojnë t'i promovojnë qëndrimet, programet, platformat, arritjet dhe aktivitetet e pjesëmarrësve në zgjedhje.

5 http://srd.org.mk/images/stories/IZBORI_2011/ZA_SLUZBEN_VESNIK_-_Pravilnik_pred_izborna_kampanja.pdf

Në këtë periudhë të gjitha informatat lidhur me zgjedhjet mund të emitohen vetëm në lajme dhe ditare.

Redaktorët, gazetarët, drejtuesit dhe prezantuesit të inkuadruar në përgaditjen e programit të radiodifuzerëve nuk guxojnë të marrin pjesë në aktivitetet parazgjedhore të pjesëmarrësve në zgjedhje për promovimin e qëndrimeve , programeve, platformave, arritjeve dhe aktiviteteve të tyre.

Nëse përcaktohen për këtë, duhet tu pushojë angazhimi në media prej ditës kur shpallen zgjedhjet deri në mbarimin e tyre.

Në programet e radiodifuzerëve nuk është e lejuar që prej shpalljes së zgjedhjeve deri në mbarimin e tyre të emtojnë reklama të organeve shtetërore dhe publike.

Radiodifuzerët kur informojnë për përgaditjet dhe veprimet e zgjedhjeve janë të obliguar të sigurojnë:

- pluralizëm politik, informata për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje
- Të jenë të hapur për mendime të ndryshme politike
- në mënyrë objektive dhe të paanshme t'i prezantojnë aktivitetet e të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje
- trajtim të barabartë të qëndrimeve dhe mendimeve të tyre me qëllim që publiku lirshëm ta formojë mendimin
- E drejta e replikës dhe korrigjim

Para fushatës zgjedhore radiodifuzerët duhet t'i respektojnë këto parime:

- të kultivojnë vlerat humane dhe morale të njeriut dhe ta mbrojnë privatësinë dhe dinjitetin e tij
- barazi në bazë të gjinisë, racës, kombësisë, përkartësisë etnike dhe sociale, bindjeve fetare, gjendjes pronësore dhe shoqërore ose të ndonjë statusi tjetër të njeriut
- të nxisë për tolerencë, respekt të ndërsjellë dhe mirëkuptim mes pjesëtarëve me përkatësi të ndryshme etnike dhe kulturore dhe të respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara.
- të nxisë mirëkuptimin ndërkombëtarë dhe bashkëpunimin, ndjenjën e drejtësisë dhe për mbrojtjen e lirive demokratike .

Gjatë raportimin për veprimet zgjedhore, radiodifuzerët duhet të kenë kujdes që të mos emitojnë përmbajtje që janë të orientuara nga rënimi i dhunshëm i rendit kushtetues, nxitje apo thirrje për agresion ushtarak ose nxitjen e urrejtjes dhe mosdurimit kombëtarë, racor, gjinor dhe fetar. Nëse vjenë deri te kjo radiodifuzerët kanë të drejtë të distancohen dhe të sigurojnë kontekst kritik për të zbutur konotacionin negativ ose akuzat.

Komentet për përgaditjet e zgjedhjeve të emituara në lajme dhe ditare duhet të jenë të ndara si kontribute të vëçanta, me emrin dhe mbiemrin e autorit ose si koment i redaksisë.

Raportimi për aktivitetet e rregullta të bartësve të funksioneve publike në këtë periudhë nuk guxon të jetë në funksion të prezantimit zgjedhor në media të asnjë subjekti politik.

Gjatë publikimit të rezultateve nga hulumtimi i opinionit publik mediat janë të obliguara të përmendin:

- emrin dhe porositësin dhe atij që ka paguar hulumtimin
- institucioni që ka kryer hulumtimin dhe metodologjinë
- të prezantojnë përmasat dhe strukturën e të anketuarve
- periudhën kur është zbatuar hulumtimi

Radiodifuzerët nuk guxojnë të publikojnë rezultate nga hulumtimet joshkencore të opinionit publik, siç janë votimi i TV spektatorëve ose dëgjuesve përmes telefonit, anekta të zbatuara në internet dhe ngjashëm.

Në intervista, debate, përballje, programe aktuale informative dhe programe informative me qasje tematike dhe të specializuara, radiodifuzerët mund t'i trajtojnë zgjedhjet.

Radiodifuzerët janë të obliguar në këto programe të sigurojnë përfaqësim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje, të pushtetit dhe opozitës, ndërsa në to nuk guxojnë të marrin pjesë kandidatët e konfirmuar nga Komisioni shtetërorë i zgjedhjeve.

REKLAMIMI I PAGUAR POLITIK

Në periudhën parazgjedhore radiodifuzerët nuk guxojnë të emtojnë reklama të paguara politike.

Përrjashtim bëjnë shpalljet dhe kumtesat për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidatëve të pavarur edhe atë vetëm në blloqe për reklama në kuadër të kohës së lejuar dhe porositësi duhet qartë të theksohet.

Në këto shpallje dhe kumtesa duhet të ketë të dhëna elementare, për kë mblidhen nënshkrimet, ku mund qytetarët ta japin nënshkrimin e tyre dhe kur gjatë ditës. Kualifikime tjera për kandidatin nuk lejohen, ndërsa televizionet ato nuk guxojnë t'i ndjekin me video ose fotografi për kandidatin.

Fushatat e KSHZ dhe të shoqatave joqeveritare për edukimin e votuesve nuk trajtohen si reklamim i paguar politik, por duhet të jenë të ndara nga pjesa tjetër e programit dhe të theksohet klienti.

BURIMET

- Rregullorja për sjelljen e radiodifuzerëve gjatë periudhës para nisjen së fushatës zgjedhore http://srd.org.mk/images/stories/IZBORI_2011/ZA_SLUZBEN_VESNIK_-_Pravilnik_pred_izborna_kampanja.pdf од 21.04.2011.

- Rregullorja për qasjen e barabartë në prezentimin në media gjatë fushatës zgjedhore
http://srd.org.mk/images/stories/IZBORI_2011/ZA_SLUZBEN_VESNIK_-_Pravilnik_za_ramnopraven_pristap_za_vreme_na_kampanja.pdf

- Kodi zgjedhor (version final), Gazeta zyrtare I RM, nr. 54 nga 14.04. viti 2011
[http://www.sec.mk/Predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_\(Precisten_tekst\).pdf](http://www.sec.mk/Predvremeni2011/IZBOREN_ZAKONIK_(Precisten_tekst).pdf)

- Doracak per mbulimin e zgjedhjeve I SHGM, QZHM, IFJ I viti 2011.

- Deklarata universale pwr tw drejtat e njeriut
<http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml>

- Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
[http://www.aopz.gov.mk/materijali/Meѓunaroden_pakt_za граѓански и политички права.pdf](http://www.aopz.gov.mk/materijali/Meѓunaroden_pakt_za_graѓanski_i_politички_prava.pdf)



Konrad
Adenauer
Stiftung



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

“Ky publikim u mundësua në suaza të programit CIVICA Mobilitas - implementuar nga CIRa dhe finansiarisht e mbështetur nga SDC. Mendimet e shprehura këtu janë mendime të autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e CIRa-së dhe SDC-së.”